

Sinjalizime

Ekskluzive | Granatë dore gjendet mbi veturë në oborrin e një shtëpie në Prizren – evakuohen banorët, kryhet shpërthimi i kontrolluar



Sinjali.com

24 Korrik 2026 07:49



Një granatë dore e pashpërthyer është gjetur mëngjesin e së enjtes mbi një veturë të parkuar në oborrin e një shtëpie në Prizren, duke alarmuar banorët dhe aktivizuar njësitë e specializuara të Policisë së Kosovës, raporton Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se rasti është zbuluar më 23 korrik, rreth orës 08:30, në rrugën *"Gani Saramati"*, në pronën e Y. B. rreth 58-vjeç.

Pas pranimi të informatës, patrullat policore kanë dalë menjëherë në vendngjarje, ku kanë vërejtur granatën e pashpërthyer mbi veturën që ndodhej brenda oborrit.

Për shkak të rrezikut, banorët janë evakuuar, ndërsa Policia ka siguruar zonën dhe ka vendosur perimetrimin e sigurisë. Në vendngjarje kanë dalë hetuesit, ekipet e forenzikës, Krimteknika dhe njësitë rajonale të hetimeve.

Burimet thonës se rreth orës 10:00 në vendngjarje ka arritur edhe njësitë për deminim, ndërsa rreth orës 11:00 granata është neutralizuar përmes një shpërthimi të kontrolluar.

Hetuesit kanë siguruar edhe pamje nga kamerat e sigurisë, të cilat pritet të analizohen për identifikimin e personit që dyshohet se e ka vendosur mjetin shpërthyes.

Motivi i ngjarjes dhe identiteti i të dyshuarit ende nuk dihen.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit, rasti është iniciuar për veprën penale *"Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm"*, ndërsa hetimet janë në vazhdim.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

banorë

Granatë dore

oborr

Prizren


shpërthim

Të tjera:



Sot varroset 79-vjeçari i cili u gjet i vdekur në Prizren

Kosovë



Ekskluzive | Aksion i madh kundër evazionit fiskal në Prizren e Suharekë – zbulohen...

Sinjalizime




Tragjedi në Prizren – 79-vjeçari gjendet i varur në objektin e shtëpisë

Sinjalizime



Zbulohen gjashtë kycje ilegale në rrjetin e ujësjellësit në Prizren

Kosovë




Aksident trafiku në Prizren, nuk dihet nëse ka të lënduar

Siguri




Ekskluzive | Sherri mes vëllezërve për biznesin në Prizren përfundon me bastisje në Ferizaj– një...

Sinjalizime



Tërmet me magnitudë 2.2 godet zonën pranë Prizrenit

Kosovë



Ekskluzive | Ndalohet për 48 orë i dyshuari që kërcënoi kryetarin e Lubiqevës dhe i vendo...

Siguri

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitness
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Fakte
Të tjera

